



Pranuar / Dorezuar Priljeqje/Prudato Reciev./Delivery	04.10.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot B: Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDM/STK	5882/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.790/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.790/2022 të datës 12.09.2022 të parashtruar nga ankuesja me banim në, kundër Komisionit të Pranimit ne Komunën e Klinës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.10.2022, mori këtë;

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën A.nr.790/2022 të datës 12.09.2022 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Komuna e Klinës me datë 17.05.2022 ka shpallur konkursin me numër të Referencës: RN00009056 për pozitën e punës grupi (Specialit i Administrimit të Përgjithshëm), konkretisht për dy pozita "Zyrtar Certifikues" dhe "Zyrtar për Regjistrimin e Bizneseve" i cili konkurs ka qenë i hapur nga data 10.06.2022 deri me datën 22.06.2022, në të cilin konkurs ka marr pjesë edhe ankuesja si kandidate për dy pozitat, e cila pas përzgjedhjes në fazën paraprake e cila kishte marr 13.6 pikë në jetëshkrim me datën 07.08.2022 ka parashtruar ankesë tek Komisioni i Pranimit.

Komisioni i Pranimit me datën 11.08.2022 ka marr vendimin me numër 02. NR.111-29018/22 me të cilin ka aprovuar ankesën e datës 07.08.2022 të parashtruar nga ankuesja duke i ndryshuar pikët e CV-se nga 13.6 pikë në 14.4 pikë.

Ankuesja e pa kënaqur me vendimin me numër 02.Nr. 111-29018/2022 të datës 11.08.2022 të Komisionit për Vlerësim me datën 12.09.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 5305/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses me numër të protokollit 5493/2022 tek Komuna e Klinës. Ndërsa Këshilli me datë 29.09.2022 ende pa pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit ,ka pranuar emalin me numër të protokollit 5748/2022 nga ankuesja e cila për arsye subjektive mbështetur në rrethanat faktike në pajtim me të drejtat e saja të garantuara me legjislacionin në fuqi ka parashtruar kërkesë për tërheqjen e ankesës A.nr. 792/2022 të datës 12.09.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5305/2022 të datës 12.09.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Njoftimin e Zyrës së Personelit me numër 02.Nr.Protokolli; 112-29152/2022 të datës 12.08.2022 lidhur me përfundimin e procedurës së rivlerësimit dhe shpalljen e rezultateve përfundimtare për grupin e profesional " *Specialist i Administrimit të Përgjithshëm* " ; Njoftimin e Zyrës së Personelit me numër Nr.Protokolli:112-27778/2022 lidhur me përfundimin e procedurës së rivlerësimit dhe shpalljen e rezultateve përfundimtare për grupin e profesional " *Specialist i Administrimit të Përgjithshëm* "; Rezultatit përfundimtar të vlerësimit paraprak të datës 01.07.2022; Ankesën e datës 07.08.2022 të parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Pranim; Shkresën e datës 09.09.2022 të dorëzuara nga ankuesja (të shkëputura nga gazeta të ndryshme lidhur me shkeljet e konkursit në fjalë); Konkursin e datës 17.05.2022 të shpallur nga Komuna e Klinës për pozitën grup, " *Specialist i Administrimit të Përgjithshëm* "; Emalin e datës 09.09.2022 të drejtuar KPMSHCK-së; Vendimin me numër 02.Nr.111-29018/22 të datës 11.08.2022 të Komisionit për Pranim; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 19.09.2022 me numër të protokollit 5493/2022; Emalin e datës 29.09.2022 me numër të protokollit 5748/2022 të drejtuar KPMSHCK-së lidhur me kërkesën për tërheqjen e ankesës, ndërsa nuk ka pasur prova që janë ofruar nga organi i punësimit nga se ende nuk janë përgjigj deri në momentin e dorëzimit të kërkesës për tërheqje të ankesës së ankueses.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dorëzuar nga ankuesja, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ lidhur me ankesën A.nr.790/2022 të datës 12.09.2022 të parashtruar nga ankuesja **sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses sikurse dhe analizimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesja ka qenë kandidate në konkursin me numër të referencës RN00009056 për grupin " *Specialist i Administrimit të Përgjithshëm* ", e njëjta ka arritur të kaloj fazën e verifikimit paraprak, e pa kënaqur me pikët lidhur me vlerësimin e CV e njëjta ka parashtruar ankesë në Komisionin e Pranimi i cili komision i ka aprovuar ankesën e ankueses mirë po ankuesja e pa kënaqur me pikët e jetëshkrimit edhe sipas vendimit të rivlerësimit sipas vlerësimit të Komisionit të

Vlerësimet me datën 12.09.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në mbështetje të nenit 103 paragrafit 1 nën të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën A.nr.790/2022 të datës 12.09.2022 pasi që ankuesja përmes kërkesës së datës 29.09.2022 të parashtruar në formë elektronike përmes emailit në KPMSHCK e cila është protokolluar me numër 5748/2022 e ka tërheq ankesën e parashtruar me datë 12.09.2022 dhe numër protokoli:5305/2022 lidhur me objektin e ankesës "kontestim konkursi" për grupin "Specialit i Administrimit të Përgjithshëm" të zhvilluar nga Komuna e Klinës.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe konstatimeve të dhëna në pasqyrimin e këtij vendimi si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda, A.nr.790/2022 ,datë 04/10/2022.

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Klinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Klinës;
- Arkiviot të KPMSHCK-së

